



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo
Opština štrpce
Komuna e Shtërpcës
Municipality of Strpce

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja a) dhe paragrafin 12.3 të Ligjit nr.-03/L-040 Per Vetqeverisje Lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr-28/2008”, nenit 34 dhe 92 të Statutit të Komunës së Shtërpcës nr 01/898 të datës 14/07/2010 Kuvendi i Komunës së Shtërpcës në mbledhjen e mbajtur më datën 26.02.2020 miratoi këtë :

VENDIM

PËR PLOTESIMIN DHE NDRYSHIMIN E STATUTIT TE KOMUNES SE SHTERPCE

Neni 1

Neni 69 paragrafi 69.1 ndryshohet dhe plotësohet ku pas paragrafit 8 shtohet paragrafi 9 siq vijon:

“9. Drejtorja e inspektoratit”.

Neni 2

Pas nenit 77 shtohet nje nen i ri 77A dhe ate siq vijon:

“Drejtorja e Inspektoratit”

77A.1 Drejtorja e inspeksionit është organ i administratës ,fushë-veprimtaria e së cilës është përcjellja ,monitorimi dhe marrja e masave ,përmes vendimeve administrative ,në funksion të mbikëqyrjes inspektuese ,të fushave të rregulluara me ligje ,akte nënligjore ,vendime dhe urdhëresa në fuqi .

77.A.2Detyrave dhe përgjegjësit e Drejtorise se Inspektoratit:

- Kryen inspektime në mbështetje te ligjit për fushat e ndryshme,
- Bën inspektimin e ndërtimeve të objekteve të ndërtimit kolektiv, privat, objekteve afariste, rrugëve dhe kanalizimeve të ujërave fekale,
- Kryen inspektimin ne fushën sanitare në mbështetje te ligjit përkatës,
- Kryen inspektimin nga fusha e veterinës në mbështetje te ligjit përkatës,
- Kryen inspektimin në fushën e mbrojtjes se ambientit në mbështetje të ligjit përkatës,
- Kryen inspektimin e veprimtarive ekonomike dhe bizneseve të ndryshme në Komunë duke kontrolluar të gjitha bizneset e regjistruara dhe ato te cilat janë të pa regjistruara dhe

ndërmerr veprimet përkatëse ligjore,

g) Kryen inspektimin financiar, inspektimin e tregut dhe çmimeve në pajtim më ligjin përkatës,

h) Kryen inspektimin nga lëmi i bujqësisë në pajtim më Ligjin përkatës,

i) Kryen inspektimin e shërbimeve komunale: rrugëve, shesheve, parqet, varrezat, përcjellja e trafikut të auto-taksive, kombi-taksi, autobusëve dhe automjeteve për transport, reklamat e ndryshme të bizneseve dhe të tjera,

j) Kryen inspektimin e pronave ku sigurohet zbatimi i ligjeve të pronës e po ashtu edhe të ligjeve dhe të rregulloreve të tjera të lidhura me pronën dhe mjedisin,

k) Kryen inspektimin rreth parandalimit dhe mbrojtjes nga zjarri si dhe fatkeqësive të tjera elementare,

l) Kryen punë dhe përgjegjësi të tjera nga lëmi i vet, të përcaktuara nga Kryetari dhe në mbështetje në ligjet përkatëse.

Neni 3

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Shterpcës ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040 për vetëqeverisje lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, dhe pas shpalljes në web-faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Predrag Grbic

